

L I G J

NR.7761, DATE 19.10.1993

PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E SËMUNDJEVE NGJIËSE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991

"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave"

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

KREU I

DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Neni 1

Me termin "semundje ngjitese" do të kuptohet grupi i semundjeve që shkaktohen nga mikroorganizma dhe parasite semundjshkaktues që transmetohen drejtpërdrejt ose terthorazi nga njeriu i semure ose bartesi të njeriu i sendoshe (antroponozat) dhe nga kafshet e produktet blegtorale të njerezit (antropozoonozat).

Neni 2

Parandalimi e luftimi i semundjeve ngjitese në territorin e Republikës së Shqipërisë është i detyrueshem.

Neni 3

Parandalimi dhe luftimi i semundjeve ngjitese organizohet dhe drejtohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe përfshin kompleksin e masave për zbulimin në kohë, evidencimin e shfaqjes, ndalimin e përhapjes dhe mjekimin e tyre.

Neni 4

Strukturat e shërbimit për luftimin e semundjeve ngjitese në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit dhe në institucionet vartëse të saj përcaktohen dhe miratohen nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

Strukturat organizative për parandalimin e luftimin e semundjeve ngjitese në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Ministrinë e Rendit Publik përcaktohen në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 5

Sherbimet e luftes kunder semundjeve ngjitese prane Drejtorise se Shendetit Publik ne Ministrine e Shendetesise dhe te Mbrojtjes se Mjedisit, ne Institutin Kerkimor te Higjenes dhe Epidemiologjise, ne Drejtorine e Shendetit Publik, si dhe ne Ministrine e Mbrojtjes, Ministrine e Bujqesise dhe Spitalin Qendror te Ushtrise, jane struktura shteterore te specializuara qe kontrollojne zbatimin e ligjshmerise ne kete fushe, ne:

- a) institucionet e sherbimit shendetesor ne te gjitha nivelet shteterore ose private;
 - b) strukturat e sherbimit shendetesor ne vartesi te Ministrise se Mbrojtjes dhe ato te Rendit Publik;
 - c) strukturat e sherbimit qeveritar ne qender e ne baze;
 - d) sektore shteterore ose private dhe veprimtarite e personave fizike e juridike te te gjitha llojeve, ku rrezikohet perhapja e te gjitha semundjeve ngjitese.
- Punonjesis e ketyre sherbimeve jane persona te specializuar.

Neni 6

Drejtoria e Shendetit Publik ne Ministrine e Shendetesise dhe Mbrojtjes se Mjedisit, mbeshtetur nga Instituti Kerkimor i Higjenes dhe Epidemiologjise e ne bashkepunim me Institutin e Kerkimeve Veterinare, si dhe nga sherbimet e epidemiologjise ne rrethe, studion, analizon dhe pergjitheson ne menyre shkencore situaten epidemiologjike te vendit dhe percakton zgjidhjet e strategji te per permiresimin e vazhdueshem te saj.

Neni 7

Te gjitha strukturat e sherbimit shendetesor paresor, si mjeku i familjes, poliklinikat, dispancerit, qendrat shendetesore, keshillimoret, ambulancat periferike e qendrat kurative kane per detyre:

- a) Te evidenojne gjendjen e semundjeve ngjitese ne territorin qe mbulojne dhe te zbatojne masat qe percaktohen ne kete ligj.
- b) Te pergatitin plankerkesat per medikamente dhe bazen materiale te nevojshme, si dhe te zbatojne skemat per imunizimin e popullsisë, mjekimin dhe mbikqyrjen e semundjeve ngjitese.
- c) Te informoje rregullisht per rastet e semundjeve ngjitese dhe mbulesen vaksinale ne sherbimet perkatese epidemiologjike.
- ç) Te bashkepunojne me sherbimet e specializuara te higjenes dhe te luftes kunder semundjeve ngjitese ne rreth, me sherbimin veterinar ne organet e pushtetit lokal dhe me shoqata te ndryshme per permiresimin e kushteve higjeniko-shendetesore te mjedisit familjar dhe atij komunitar dhe per ngritjen e nivelit te njohurive shendetesore te popullates.

Neni 8

Organet e shendetesise te te gjitha niveleve detyrohen te informojne rregullisht per situaten e semundjeve ngjitese e masat parandaluese, organet e pushtetit lokal ne territorin ku veprojne.

Organet e pushtetit lokal detyrohen te mbeshtesin veprimtarine e punonjesve te shendetesise per zbatimin e masave per parandalimin dhe luftimin e semundjeve ngjitese, te parashikuara ne kete ligj.

KREU II

PËR MASAT E LUFTIMIT TË SËMUNDJEVE NGJITSE

Neni 9

Ministria e Shendetesise dhe e Mbrojtjes se Mjedisit, ne rast perhapjeje masive te semundjeve ngjitese, eshte e detyruar te marren masa te energjences, te cilat percaktohen ne akte nenligjore.

Neni 10

Ministria e Shendetesise dhe e Mbrojtjes se Mjedisit mbulon shpenzimet, brenda buxhetit vjetor te parashikuar per sigurimin e preparateve imunobiologjike, medikamenteve dhe bazes tjeter materiale te domosdoshme per parandalimin, diagnostifikimin dhe mjekimin e semundjeve ngjitese, sipas nevojave te institucioneve shendetesore.

Per garantimin e masave parandaluese dhe mjekuese te semundjeve ngjitese, perfitojne mjekime, analiza e vaksina gratis nje kategori personash te semure dhe persona te tjere, te percaktuar nga Keshilli i Ministrave.

Ministri i Shendetesise dhe i Ruajtjes se Mjedisit propozon dhe i kerkon Keshillit te Ministrave mbeshtetje financiare per raste te jashtezakonshme epidemike.

Neni 11

Ministria e Shendetesise dhe e Mbrojtjes se Mjedisit organizon dhe drejton sherbimin sanitaro-antiepidemik ne pikat e kalimit kufitar detar, ajror e tokesor, ne pershtatje me trafikun dhe situaten epidemiologjike, per te siguruar parandalimin e hyrjes se semundjeve te rrezikshme te Konventes, ne perputhje me normat e percaktuara ne rregulloren sanitare nderkombetare.

Neni 12

Denoncimi dhe regjistrimi i semundjeve ngjitese te vertetuara ose te dyshuara e bartesit e tyre behen prane sherbimit te luftes kunder semundjeve ngjitese ne Drejtorine e Higjenes dhe e Epidemiologjise dhe ne drejtorite e shendetit publik te rrethit nga te gjitha institucionet shendetesore, shtetore ose private, si spitalet infektive dhe joinfektive, piliklinikat, dispanceri, qendrat shendetesore, mjeku i familjes dhe nga mjeket e institucioneve shkollore e parashkollore.

Neni 13

Per parandalimin dhe luftimin e semundjeve ngjitese, institucionet shendetesore qe percaktohen ne nenin 12, pika "b", detyrohen te marrin masa per zbulimin ne kohe, shtrimin ne spital ose trajtimin ne shtepi, izolimin e vaksinimin ne perputhje me rregullat perkatese.

Institucioni shendetesor ose privat qe ka bere denoncimin dhe mjekimin e te semureve me semundje ngjitese, eshte i detyruar te njoftoje edhe per perfundimin e semundjes.

Neni 14

Per te gjitha semundjet ngjitese qe transmetohen nga kafshet ne njerez (zoonozat) behet njoftimi i ndersjelle ndermjet organeve shendetesore e veterinare te te gjitha niveleve, shtetore ose private, dhe bashkepunohet per marrjen e masave antiepidemike dhe antiepidemike, sipas dispozitave te ketij ligji dhe te ligjit nr.7674, date 23.2.1993 "Per sherbimin dhe inspektoriatin veterinar".

Neni 15

Ministria e Shendetesise dhe e Mbrojtjes se Mjedisit percakton me akte nenligjore:

- a) Listen e semundjeve ngjitese qe duhet te denoncohen, regjistrohesh dhe raportohen.
- b) Menyren e denoncimit te semundjeve ngjitese
- c) Llojet e semundjeve ngjitese, mjekimi i te cilave duhet te behet detyrimisht ne spital
- ç) Masat e pergjithshme a te vecanta per secilen semundje ngjitese, duke perfshire edhe ato te luftimit te brejtesve dhe insekteve, kur paraqesin indikacion epidemiologjik.
- d) Dokumentacionin e nevojshem per denoncimin, regjistrimin, anketimin e semundjeve ngjitese dhe vaksinimin.

Neni 16

Ne rast shfaqjeje te semundjeve ngjitese, epidemiologet, ndihmesepidemiologet dhe punonjesit e tjere te ngarkuar per zbatimin e masave parandaluese e mjekuese, kane te drejte te hyjne ne cdo kohe ne ndermarrje, institucion shtetor ose privat dhe reparte ushtarake, ndersa ne banese vetem per te shmangur nje rrezik te aytpertatyshem per jeten dhe shendetin e njerezve, per te bere hetimin epidemiologjik, izolimin, shtrimin ne spital, mbikeqyrjen shendetesore te kontakteve, vaksinimin, depistimin, dezinfektimin e mjekimin profilaktik.

Kur punonjesit e mesiperme hasin pengesa ne kryerjen e detyres, kerkojne mbeshtetjen e organeve te rendit publik.

Subjektet qe kane te drejte te hyjne ne objektet e mesiperme, percaktohen nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes se Mjedisit dhe pajisen me libreze identiteti.

Neni 17

Me kërkesen e shërbimeve të specializuara për luftën kundër sëmundjeve ngjitëse, organet e rendit publik janë të detyruara të ndihmojnë, sa herë që hasen pengesa, për plotësimin e detyrave të parashikuara në këtë ligj.

Neni 18

Drejtpërdrejtuesit ose pronarët, vendas a të huaj, të ndërmarrjeve, objekteve ose institucioneve shtetërore, shoqërore ose private, si dhe shtetasit, janë të detyruar të zbatojnë detyrat e lëna nga epidemiologët dhe ndihmesepidemiologët, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nenligjore, kur në mjedisin e objekteve të mesipërme është shfaqur qoftë edhe një rast me sëmundje ngjitëse.

Neni 19

Për të ndjekur organizimin dhe masat e luftimit të lebrës në shkallë vendi ngarkohet klinika e sëmundjeve të lekures pranë Qendres Spitalore Universitare të Tiranës, e cila bashkëpunon me shërbimet epidemiologjike dhe dispancerit përkatëse të rrethëve.

Neni 20

Për parandalimin dhe luftimin e SIDA(AIDS) ngrihen komisioni kombëtar dhe institucionet e tjera shëndetësore në nivel kombëtar e lokal, veprimtaria e të cilave drejtohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 21

Qendrat e dhurimit të gjakut janë të detyruara të bëjnë kontrollin shëndetësor paraprak (laboratorik) të gjithë dhuruesve, sa herë që ata paraqiten për të dhuruar gjak. Përfshihen gjithashtu si dhurues të gjakut personat që kanë rezultuar seropozitivë me SIDA(AIDS) hepatit viral, malarje ose me sëmundje të tjera që transmetohen me anë të gjakut a të nënprodukteve të tij.

Neni 22

Institucionet shëndetësore shtetërore ose private janë të detyruara të zbatojnë normat e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë për sterilizimin dhe dezinfektimin e mjeteve të përdorimit kirurgjikal dhe medikosanitar.

KREU III

MASA PËR IMUNIZIMIN E POPULLSISË

Neni 23

a) Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit harton dhe zbaton programin e gjërë të imunizimit (vaksinimit).

b) Prane Ministrise se Shendetesise dhe te Mbrojtjes se Mjedisit ngrihet "Komiteti Kombetar i Imunizimit", si organ konsultativ qe percakton politiken e vaksinimit ne shkalle vendi.

c) Ministria e Shendetesise percakton kalendarin e vaksinimit te detyrueshem kunder semundjeve te difterise, kolles se mire, tetanozit, fruthit, poliomielitit, tuberkulozit si dhe menyren e ruajtjes, te transportimit dhe te aplikimit te vaksinave.

Neni 24

Vaksinimi i detyrueshem realizohet ne moshat 0-15 vjeç dhe ne grate shtatezana nga keshillimoret, mjeku i familjes, nga ambulancat dhe qendrat shendetesore.

Institucionet e mesiperme jane te detyruara te sigurojne evidencimin e sakte te kontigjenteve qe i nenshtrohen vaksinimit, planin e vaksinimit dhe sasite e nevojshme te vaksinave te ruajtura ne kushtet e "zinxhirit te ftohte".

Neni 25

Institucionet shendetesore qe jane ngarkuar me vaksinimin, jane te detyruara te pajisin me libezen e vaksinimit gjithe personat qe i nenshtrohen vaksinimit. Libreza e vaksinimit kerkohet dhe plotesohet sa here qe aplikohen vaksinat.

Neni 26

Per cdo dryshim qe behet ne vendbanim, brenda perbrenda rrethit ose jashte rrethit, zyra e gjendjes civile nuk mund te bejne asnje regjistrim, pa pasur dokumentin zyrtar te firmosur nga titullari i institucionit shendetesor (poliklinikes, qendres shendetesore) qe te vertetojne regjistrimin ne keshillimore ose ne ambulance te femijeve qe i perkasin seciles familje qe transferohet.

Neni 27

Per cdo femije qe hyn per here te pare ne shkolle (6-7 vjeç), detyrohet pajisja e tij prej institucioneve shendetesore me nje dokument qe provon vaksinimin e kryer sipas kalendarit.

Kerkesa e ketij dokumenti dhe ruajtja e tij nga drejtorite perkatese te shkollave eshte i detyrueshem.

Neni 28

Per te penguar perhapjen e semundjeve ngjitese qe nuk perfshihen ne nenin 23, shkronja "e", Ministria e Shendetesise dhe e Mbrojtjes se Mjedisit organizon kryerjen e vaksinimit me indikacion epidemiologjik, si dhe per qellimet e udhetimit nderkombetar.

KREU IV

KUNDERVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 29

Shkeljet e meposhtme, kur nuk formojne veper penale, perbejne kundervajtje administrative:

1. Mosdenoncimi, mosregjistrimi i semundjeve ngjitese, mosraportimi i tyre dhe i vaksinimeve, denohen me gjobe nga 200-1000 leke.
2. Mosmarrja e masave ne vatrat e infeksionit, si anketimi, shtrimi ne spital, kur eshte percaktuar i detyrueshem, largimi nga kolektiviteti(cerdhe, kopsht, shkolle, azil, spital etj.), desinfektimi, dezinfektimi, deratizimi, vaksinimi, mjekimi profilaktik e observimi denohen me gjobe nga 300-3000 leke.
3. Moszbatimi i kalendarit te vaksinimit te detyrueshem, mosregjistrimi i personave qe duhen vaksinuar, mosmbajtja ne kushtet e "zinxhirit te ftohte" te vaksinave, falsifikimi dhe korrigjimi i dokumenteve te vaksinimit denohen me gjobe nga 500-5000 leke.
4. Moskryerja e analizave laboratorike, diagnostikuese, profilaktike dhe te rikontrollit denohet me gjobe nga 200-5000
5. Perdorimi i materialeve medikosanitare te pasterilizuara dhe te rikontrollit denohet me gjobe nga 500-5000 leke.

Masa me e vogel e denimit eshte deri 2000 leke.

Kur shkeljet administrative sjellin pasoja te renda ne shendetin e njerezve, ceshtja denoncohet per ndjekje penale ne organet e prokurorise.

Neni 30

Per kundervajtjet administrative te parashikuara sipas nenit 29 te ketij ligji denimet me gjobe jepen nga :

1. Mjeket epidemiologe dhe inspektoret e sektorit te mjekesise parandaluese ne Ministrine e Shendetesise dhe te Mbrojtjes se Mjedisit.
2. Epidemiologet dhe nd/epidemiologet e rrethit, te Institutit te Higjenes dhe Epidemiologjise, te Ministrise se Mbrojtjes dhe te Ministrise se RenditPublik.
3. Persona te tjere te autorizuar nga Ministria e Shendetesise dhe e mbrojtjes se Mjedisit. Subjektet e mesiperme pajisen me libreze identiteti.

Neni 31

Shqyrtimi i kundervajtjeve administrative, ankimi kunder vendimeve te denimit dhe ekzekutimi i vendimeve behet sipas ligjit nr.7697, date 7.4.1993 "Per kundervajtjet administrative."

Neni 32

Dekreti nr.1894, date 5.7.1954 "Per luftimin e semundjeve ngjitese", ndryshuar me dekret nr.4360 date 16.1.1968 dhe nr.5439, date 15.10.1976, si dhe çdo dispozite tjeter qe bie ne kundërshtim me kete ligj, shfuqizohen.

Neni 33

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.672, date 29.10.1993 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Sali Berisha.

L I G J

Nr.8032, datë 16.11.1995

PËR SHERBIMIN E TRANSFUZIONIT DHE KONTROLLIN E GJAKUT, PRODUKTEVE TE TIJ DHE TRANSPLANTIMEVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991
"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim garantimin e sigurisë për të gjitha manipulimet që lidhen me gjakun, produktet e tij dhe transplantet.

Neni 2

Ky ligj zbatohet për të gjitha manipulimet e gjakut, produkteve të qëndrueshme të tij dhe transplantet.

Ky ligj nuk zbatohet për:

- a) fabrikimin, shpërndarjen, magazinimin dhe regjistrimin e produkteve të qëndrueshme të gjakut;
- b) gjakun dhe produktet e tij që nuk destinohen për përdorim te njerëzit.

Neni 3

Në kuptim të këtij ligji:

- a) gjak është gjaku i njeriut;
- b) produkte të gjakut janë produkte që kanë si bazë gjakun;
- c) produkte të paqëndrueshme gjaku janë produktet që përftohen direkt nga gjaku i njeriut ose pas disa fazave të fabrikimit dhe që ndryshojnë me shpejtësi, pavarësisht nga veprimet e jashtme (p.sh. përgatitja qelizore ose plazma);
- ç) produkte të qëndrueshme gjaku janë produktet e përfutuara në mënyrë industriale me disa faza fabrikimi dhe me konservim të gjatë (p.sh. preparatet e koagulimit, albuminës dhe imunoglobulinat);
- d) transplante janë organe, qeliza dhe inde me origjinë njerëzore ose shtazore të destinuara për t'p'u transferuar te njeriu;
- dh) manipulim janë çdo lloj veprimtarie në lidhje me gjakun, produktet e gjakut dhe transplantimet, si marrja, fabrikimi, përgatitja, importimi, eksportimi, magazinimi, transfuzioni dhe tregtimi;
- e) transfuzion është administrimi i gjakut ose produkteve të paqëndrueshme të gjakut në persona që kanë dhënë gjak (transfuzion me gjakun e vet), ose në persona të ndryshëm nga ata që kanë dhënë gjak (transfuzion i gjakut në të tretë).

Neni 4

Të gjithë personat që manipulojnë gjakun, produktet e gjakut dhe transplantet duhet të marrin të gjitha masat për të mos rrezikuar shëndetin e njerëzve që japin ose marrin këto produkte.

KREU II

ORGANIZIMI I STRUKTURAVE

Neni 5

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit është organi shtetëror që autorizon dhe kontrollon organet që merren me manipulimin e gjakut, produkteve të tij dhe transplanteve.

Ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit miraton përbërjen dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Gjakut, i cili është organ konsultativ teknik e shkencor.

Neni 6

Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut drejton dhe ka në varësi teknike dhe administrative qendrat e transfuzionit të gjakut në rrethe.

Neni 7

Qendrat e transfuzionit të gjakut në rrethe kanë për detyrë:

- të rekrutojnë dhuruesit e gjakut;
- të pyesin dhe të ekzaminojnë dhuruesit sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore;
- të marrin gjak nga dhuruesit;
- të furnizojnë me gjak dhe produkte të tij qendrat spitalore;
- të hartojnë dhe të ruajnë dokumentacionin e nevojshëm për të gjitha procedurat e kryera;
- të sigurojnë përgatitjen e gjakut të konservuar dhe produkteve të tij;
- të administrojnë bankat e gjakut.

Neni 8

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, me strukturat organizative të saj nga qendra në bazë, përgjigjet për plotësimin e nevojave që kanë Forcat e Armatosura për gjak dhe produkte të tij në kohë paqeje dhe në kohë të veçantë.

Ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit miratojnë rregulloren e përbashkët për manipulimet me gjakun dhe produktet e tij në Forcat e Armatosura.

Ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit miratojnë rregulloren e përbashkët për manipulimet me gjakun dhe produktet e tij në shërbimin e transfuzionit të Forcave të Armatosura.

Neni 9

Shoqatat e dhuruesve vullnetarë të gjakut ndihmojnë organet përkatëse në zbatimin e dispozitave të këtij ligji, me qëllim që të mbrojnë dhuruesit e gjakut dhe të përmirësojnë shërbimin e transfuzionit në shkallë vendi.

Neni 10

Trajtimi i dhuruesve rregullohet me akte nënligjore të vendosura nga Qeveria.

KREU III

MANIPULIMI I GJAKUT DHE PRODUKTEVE TË TIJ

Neni 11

Të gjithë personat që kryejnë veprimtaritë e mëposhtme pajisen me autorizimin përkatës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit:

- a) marrje e gjakut me qëllim transfuzioni ose dhënie të tretëve;
- b) marrje e gjakut me qëllim fabrikimi të produkteve të gjakut ose për t'ua dhënë të tretëve për këtë qëllim;
- c) fabrikim i produkteve të paqëndrueshme të gjakut;
- ç) magazinim i produkteve të paqëndrueshme të gjakut;
- d) importim i gjakut ose produkteve të tij;
- dh) eksportim i gjakut ose produkteve të tij.

Autorizimi lëshohet në rast se plotësohen kushtet e kualifikimit profesional, kushtet e përshtatshme të manipulimit dhe cilësia farmaceutike.

Neni 12

Lejohet vetëm importimi i produkteve të qëndrueshme të gjakut.

Për çdo importim të produkteve të qëndrueshme të gjakut kërkohet një autorizim i veçantë. Vendosja në ruajtje në një magazine doganore konsiderohet importim.

Në raste situatash të jashtëzakonshme, ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit autorizon importimin e gjakut dhe/ose produkteve të paqëndrueshme të tij.

Neni 13

Personi që ka autorizimin kontrollon me anë të pyetjeve, ekzaminimeve mjekësore dhe testeve nëse dhuruesi është i përshtatshëm për të dhënë gjak.

Neni 14

Dhuruesit përjashtohen nga dhënia e gjakut në rast se

- a) shëndeti i dhuruesit dëmtohet nga dhënia e gjakut;
- b) gjaku mund të transmeojë agjentë patogjenë te personat që do ta marrin atë.

Neni 15

Gjaku ruhet dhe produktet e paqëndrueshme të tij të fabrikohen në përputhje me rregullat teknike e mjekësore të përcaktuara për këtë qëllim.

Neni 16

Gjaku i marrë ekzaminohet për të evidencuar praninë ose jo të agjentëve patogjenë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit miraton ekzaminimet që duhen kryer.

Neni 17

Gjaku që del pozitiv nga ekzaminimet, nuk duhet të përdoret për transfuzion ose për fabrikim të produkteve të gjakut.

Personi që kryen marrjen e gjakut duhet të informojë menjëherë dhuruesin për rezultatet e ekzaminimeve.

Informimi i dhuruesve që rezultojnë seropozitivë për infeksionin HIV/AIDS bëhet nga personat e caktuar për këtë qëllim.

Neni 18

Gjaku, produktet e paqëndrueshme të tij dhe kampionet e analizave etiketohen në mënyrë të tillë që të jenë të identifikuar në çdo kohë.

Neni 19

Personi i pajisur me autorizim duhet të regjistrojë të gjitha veprimet e rëndësishme për sigurinë e shëndetit, si marrjen e gjakut, kontrollin, shpërndarjen, ruajtjen, dhënien e tij, eliminimin e gjakut të infektuar ose produkteve të tij.

Për çdo marrje gjaku duhet të regjistrohen:

- a) data e marrjes së gjakut, identiteti dhe datëlindja e dhuruesit;
- b) rezultatet e testeve serologjike dhe interpretimin e atij që ka kryer testimin.

Për dhuruesit e përjashtuar nga dhënia e gjakut duhet të regjistrohen:

- a) identiteti dhe datëlindja;
- b) data dhe arsyeja e përjashtimit.

Neni 20

Personi i pajisur me autorizim duhet t'i ruajë të gjitha dokumentet e rëndësishme sipas afateve të përcaktuara në rregulloret e miratuara për këtë qëllim.

Quhen dokumente të rëndësishme:

- a) të dhënat për dhuruesit;
- b) rezultatet e analizave laboratorike;
- c) regjistrimet lidhur me marrjen e gjakut, kontrollin, shpërndarjen, ruajtjen, dhënien e tij, eliminimin e gjakut të infektuar ose produkteve të tij.

Personi juridik që kryen transfuzione të gjakut ose të produkteve të tij te pacientët duhet të ruajë për 10 vjet të dhënat për identitetin dhe datëlindjen e personit që e mori, si dhe emrin, etiketimin dhe origjinën e gjakut ose të produkteve të gjakut.

Neni 21

Personi që kryen marrjen e gjakut duhet të sigurohet për identitetin e dhuruesit.

Neni 22

Në rast se personi që kryen marrjen ose dhënien e gjakut vëren faktorë që kërcënojnë shëndetin e atij që i jepet gjak, duhet të marrë menjëherë masat e nevojshme dhe të informojë organet kompetente.

Neni 23

Dhënia e gjakut dhe e produkteve të tij bëhet në qendrat spitalore të autorizuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Dhënia e gjakut bëhet vetëm pasi të jetë përcaktuar saktë grupi i gjakut si dhe të gjitha provat e tjera, sipas rregulloreve përkatëse.

Dhënia e gjakut bëhet me përshkrim të mjekut dhe në prininë e tij.

Neni 24

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit nxjerr udhëzimet e nevojshme në zbatim të këtij ligji.

Udhëzimet duhet të përcaktojnë:

1. Kërkesat lidhur me përshtatshmërinë e personave që japin gjak.
2. Mënyrën dhe personin që do të përcaktojë përshtatshmërinë.
3. Rregullat e fabrikimit.
4. Agjentët patogjenë ose treguesit e pranisë së tyre, mbi të cilët kryhen ekzaminimet dhe testimet.
5. Etiketimin e gjakut dhe të produkteve të paqëndrueshme të tij.
6. Kalimin të të tretët dhe ruajtjen e dokumenteve gjatë kohës që ndërpritet veprimtaria dhe nuk është plotësuar afati i ruajtjes së tyre.
7. Detyrimet e personit të autorizuar për manipulimin me gjakun sipas nenit 5.
8. Procedurat e dhënies së autorizimit, kushtet e kualifikimit profesional, kërkesat që duhet të plotësojë sistemi i sigurimit të cilësisë farmaceutike, si dhe procedurat e pezullimit dhe heqjes së autorizimit.
9. Kushtet që lidhen me autorizimin për importimin e gjakut dhe produkteve të tij.
10. Kushtet që lidhen me autorizimin për eksportimin e gjakut dhe produkteve të tij.
11. Masa të tjera të veçanta sigurie për gjakun dhe produktet e tij.

KREU IV

MANIPULIMI I TRANSPLANTEVE

Neni 25

Gjithë personat që kryejnë veprimtaritë e mëposhtme duhet të kërkojnë autorizimin përkatës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit:

- a) heqje e transplantave nga njeriu ose kafsha për t'i transplantuar te njeriu ose për t'pua dhënë të tretëve për këtë qëllim;
- b) ruajtje, importim, kalim të tretëve ose vendosje transplantesh.

Neni 26

Gjithë personat që kryejnë veprimtaritë e përmendura në nenin 25 duhet të sigurohen që organi, personi dhurues ose kurues nga është marrë transplant, është testuar për prani të agjentëve patogjenë ose tregues të pranisë së këtyre agjentëve.

KREU V

KONTROLLI

Neni 27

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore nëpërmjet shërbimit të inspektimit dhe laboratorëve të përcaktuar prej tij.

Neni 28

Organet e inspektimit kontrollojnë gjakun, produktet e gjakut, transplantet, procedurën e marrjes së gjakut, procedurat e fabrikimit të produkteve të gjakut, sistemin e sigurimit të cilësisë, lokalet, instalimet dhe mjetet e transportit.

Organet e inspektimit kanë të drejtë të marrin kampione për verifikime të mëtejshme ose të ngarkojnë shërbimet e doganave për të marrë kampione pa shpërblim.

Organet e inspektimit kanë të drejtë, në kufirin e detyrave të përcaktuara në këtë ligj, të hyjnë në ndërtesa, ndërmarrje, locale dhe mjete transporti.

Neni 29

Gjithë personat që manipulojnë gjakun, produktet e tij ose transplantet, detyrohen të mos pengojnë shërbimin e inspektimit në kryerjen e detyrave të tij, t'i japin informacionet e nevojshme dhe t'i lejojnë të shqyrtojë dokumentacionin.

Neni 30

1. Organet e inspektimit bllokojnë jakun, produktet e gjakut, transplantet, procedurën e marrjes së gjakut, procedurat e fabrikimit të produkteve të gjakut, sistemin e sigurimit të cilësisë, lokalet, instalimet dhe mjetet e transportit, të cilat nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji.

2. Organet e inspektimit urdhërojnë marrjen e masave të nevojshme dhe vendosin nëse objektet e bllokuara:

- a) mund të përdoren në kushte të caktuara;
- b) duhen eliminuar nga personat përgjegjës;
- c) duhen konfiskuar dhe eliminuar me shpenzimet e personave përgjegjës.

3. Organet e inspektimit mund të pezullojnë përfundimisht ose për një afat të caktuar procedurat e marrjes së gjakut, procedurat e fabrikimit të produkteve të gjakut, si dhe përdorimin e lokaleve, instalimeve ose mjeteve të transportit.

4. Në rast se kushtet në një objekt vënë në rrezik direct shëndetin publik, organet e inspektimit mund të urdhërojnë mbylljen e menjëhershme të tij.

5. Përgjegjësia për shkeljen e dispozitave të këtij ligji përcaktohet në aktet nënligjore dhe rregulloret e miratuara në zbatim të tij.

Neni 31

Organet e inspektimit sekuestrojnë gjakun, produktet e tij ose transplantet e bllokuara në rastet kur kjo masë është e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit.

Ato mund të urdhërojnë dorëzimin zyrtar të produkteve të sekuestruara në rast se rreziqe të veçanta e bëjnë të nevojshme këtë masë.

Neni 32

Personat e ngarkuar në zbatimin e këtij ligji janë të detyruar të ruajnë sekretin e mësuar gjatë kryerjes së veprimtarive ose ushtrimit të detyrës.

KREU VI

SANKSIONE

Neni 33

Shkelja e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbën veprë penale, dënohet nga organet e inspektimit me gjobë nga 10 mijë deri në 100 mijë lekë:

- a) mosmarrja e masave të nevojshme për të shmangur rrezikimin e shëndetit të personave që janë objekt i manipulimeve me gjakun, produktet e tij ose transplantet (neni 13, 17);
- b) moskryerja e testeve të gjakut, produkteve të tij ose transplanteve për evidencimin e agjentëve patogjenë (neni 16);
- c) kryerja e manipulimeve pa autorizimin përkatës (neni 11)
- ç) fabrikimi dhe ruajtja e produkteve të gjakut në kundërshtim me rregullat dhe udhëzimet përkatëse (neni 15);
- d) etiketimi i parregullt i gjakut ose produkteve të tij (neni 18);
- dh) shkelja e dispozitave të parashikuara në nenet 13, 14, 20;
- e) mosbashkëpunimi me organet e inspektimit (neni 29) dhe mosruajtja e sekretit (neni 32);
- ë) moszbatimi i detyrave të lëna nga organet e inspektimit.

Neni 34

Ankimi kundër vendimeve të organit të inspektimit dhe ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 35

Në ligjin nr.7761, datë 19.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse", pika 5 e nenit 29, si dhe gjithë dispozitat e tjera që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 36

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1308, datë 30.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha

L I G J

Nr.8484, date 10.5.1999

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7761, DATË 19.10.1993 "PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE"

Në mbeshtetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutes, me propozimin e Keshillit të Ministrave

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ne ligjin nr.7761, date 19.10.1993 "Per parandalimin dhe luftimin e semundjeve ngjitese", ne nenin 23 pas shkronjes "c" shtohen shkronjat "ç" dhe "d" me kete permbajtje:

"ç) Ndryshimet e skemes se vaksinimit (ne kalendarin e detyrueshem te vaksinimit), te percaktuara ne shkronjen "c", behen nga Ministria e Shendetesise, sipas rekomandimeve te Organizates Boterore te Shendetesise (OBSH).

d) Ministria e Shendetesise propozon dhe miraton aktet nenligjore perkatese per kontrollin, kushtet teknike dhe llojet e vaksinave qe mund te importohen dhe mund te tregtohen privatisht, jashte kalendarit te vaksinimit."

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2373, date 20.5.1999 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Rexhep Meidani